



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.364/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Edona Grajçevci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Drenasit, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Drenas, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterit në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 12.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa A.nr.364/2021 e datës 10.02.2021 e ushtruar nga Drejtoria e Inspeksionit të Komunës së Drenas, ndërsa subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Drenas, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit për fushatën zgjedhore mbi rrugë publike, në pronën e rrugës N9 të Kosovari dhe përgjatë autostradës deri në Korrotic të Lartë, si dhe në rrugën “Bedri Shala” dhe në rrugën “Xhevat Dermaku” ka të vendosur postera të shtylla elektrike në formatin A4 të partive politike të kandidatit Ramush Haradinaj – AAK, në Komunën e Drenasit, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,500.00 (njëmijë e pesëqind) euro.

II. DETYROHET Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Drenas, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesërisht ankesa A.nr.364/2021 e datës 10.02.2021 e ushtruar nga Drejtoria e Inspeksionit të Komunës së Drenas për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterit për fushatën zgjedhore mbi rrugë publike, që ka të beje me kandidatit për deputet Beqir Kiqina –AAK.

A r s y e t i m

Drejtorja e Inspeksionit në Drenas, ka parashtruar ankesë Anr.364/2019 me datë 10.02.2021, me të cilën pretendon se në rrugën publike përkatësisht në pronën e rrugës N9 të Kosovari dhe përgjatë autostradës deri në Korrotic të Lartë, si dhe në rrugën “Bedri Shala” dhe në rrugën “Xhevat Dermaku” ka të vendosur postera të shtylla elektrike në formatin A4 të partive politike të kandidatit Beqir Kiqina-AAK, në Komunën Drenasit. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 11.02.2021, subjekti politik AAK, thekson se në rastin konkret, ankesa e parashtruar konstatohet se verifikimi i shkeljes së pretenduar është bërë me datë 08.02.2021, ndërsa ankesa e lidhur me këtë shkelje të pretenduar është paraqitur në PZAP me datë 10.02.2021 në ora 10:50, e që rrjedhimisht kjo ankesë është e pasafatshme. Bazuar në faktin e pakontestueshëm që ankesa nuk është parashtruar brenda 24 orëve nga shkelja e supozuar kërkojmë nga PZAP të hidhet poshtë si e pasafatshme, sepse nga momenti se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar deri në momentin e parashtrimit të ankesës kanë kaluar 24 orë.

Ritheksojmë që ankesa është e pasafatshme, mirëpo edhe sikur të ishte ushtruar brenda afatit e njëjta do të ishte e pabazuar. Në bazë të fotografive të prezantuara si provë në shkresat e lëndës nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet në nenin 117 par.3 të LZP-së, për tu provuar se shkelësi i supozuar ka vendosur ndonjë poster në hapësira publike ritheksojmë se reklamat janë vendosura në vendet e dedikuara për reklamim. Po ashtu nga fotografit e paraqitura si provë nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë dhe bindëse nëse eventualisht ndonjëri nga kandidatët e AAK-së ka vendosur poster në hapësira publike. Përkatësisht në asnjërën prej fotografive nuk shihet ndonjë poster i ndonjë kandidati të AAK-së.

Gjithashtu, parashtruesi i ankesës nuk ka specifikuar datën dhe kohën se kur ka ndodhur shkelja e supozuar, që kërkohet sipas dispozitës së nenit 3.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

Andaj duke marrë parasysh të cekurat më lartë i propozojnë Panelit që ankesën ta hedhë poshtë si e pasafatshme ose të refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar pjesërisht

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore-posteri i kandidatit për deputet nga subjektit politik AAK, është vendosur në hapësirat publike-rrugë, përkatësisht ne prona private, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjektit politik AAK, nuk mund të sanksionohen si shkelje të LZP-së, për arsye se vendosja e materialeve zgjedhore-posterave në shesh dhe shfrytëzimin e hapësirës të dedikuara për poster nuk përbën shkelje, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që, me këto prova nuk justifikon veprimet që janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 33 pika b) i LZP-së, Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në përgjigjën në ankesë ka theksuar se janë te vendosura ne vendet e përcaktuara për reklamim. Posterët e vendosur nga kandidatet per deputet si ne piken -I-, te dispozitivit, qe rezultojnë se janë vendosur ne hapësira publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton “*Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve*”, qe sipas raportit te Inspektoratit te Komunës se Drenasit rezulton se panot me

kandidatin Ramush Haradinaj nga AAK-ja, janë te vendosura ne Rrugën K9 ne konstruksione qe janë te vendosura ne hapësira publike.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik AAK, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore.

Sa i përket pikës III te diapozitivit te kandidatit për deputet Beqir Kiqina – AAK, paneli nga provat qe Inspektorati ka bashkangjitur ankesës nuk ka mundur te evidentoj asnjë pano /poster te këtij kandidati, për panelin ankesa është e pa mbështetshme ne provat qe janë bashkangjitur, pasi qe nuk rezulton te jete provuar shkelja e tille, gjithnjë siç ka konstatuar inspektorati se ato pano/postera janë vendosur ne shtylla elektrike, mirëpo nga provat qe janë bashkangjitur nuk munde te vërehen panot/posterët e këtij kandidati.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimmarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 364/2021 më datën 12.02.2021

Kryesuesi i Panelit
Burim Adem



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118.1 të LZP-së,